



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Shtator 2023

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Shtator 2023

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në këtë edicion të këtij Buletini pasqyrohen
aktivitetet për muajin shtator të vitit 2023)**

Konfirmohen katër kandidatë për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë

Prishtinë, 6 shtator 2023

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Jetish Maloku, së bashku me Ushtruesen e Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit dhe Ushtruesen e Detyrës së Drejtorit të NJSHPP-së, në bazë të Rregullores 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, ka bërë hapjen e aplikacioneve dhe ka shikuar materialet e pranuar nga katër kandidatë, të cilët kanë aplikuar për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë.



Pas shikimit të materialeve të dorëzuara nga ana e kandidatëve, Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku, duke u bazuar në mandatin e tij dhe në kriteret e parapara me rregullore, ka konfirmuar se të gjithë kandidatët që kanë aplikuar plotësojnë kriteret dhe konsiderohen formalisht kandidatë për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë.

Kandidatët që kanë aplikuar për këtë pozitë dhe që kanë plotësuar kriteret janë:

Dëshirë Jusaj, Prokurore e Shtetit në Prokurorinë Themelore në Gjakovë;

Ardita Beqiraj-Hyseni, Prokurore e Shtetit në Prokurorinë Themelore në Gjakovë;

Enis Gashi, Prokuror i Shtetit në Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe

Anton Hasanaj, Prokuror i Shtetit në Prokurorinë Themelore në Gjakovë.

Ndërkaq, Këshilli Prokurorial i Kosovës do të njoftojë me kohë për procedurat e tjera të procesit të zgjedhjes së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë.

Zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial viziton Drejtorinë e Policisë Rajonale në Prishtinë

Prishtinë, 7 shtator 2023

Zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), njëherësh Kryetari i Komisionit për Administrimin e Prokurorive, z. Veton Shabani, me bashkëpunëtorë, ka vizituar Drejtorinë e Policisë Rajonale në Prishtinë, ku është pritur në takim nga Drejtori i kësaj drejtorie, z.Basri Shabani, me bashkëpunëtorë.



Vizita e sotme është realizuar në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë lidhur me shkëmbimin elektronik të të dhënave përmes sistemeve që janë vënë në zbatim, me ç'rast janë diskutuar çështje me interesit të përbashkët dhe rrjedhimisht edhe sfidat, me të cilat ballafaqohen institucionet prokuroriale dhe ato të Policisë së Kosovës.

Sidomos, gjatë këtij takimi, janë diskutuar në mënyrë të detajuar aspektet që kanë të bëjnë me sigurimin e numrit personal për të gjitha llojet e palëve, regjistrimin e tyre, regjistrimin e veprave penale, trajtimin me kujdes të dyfishimit të lëndëve (sidomos ato të krimeve ekonomike), bashkëngjitjen e dokumenteve adekuate dhe dërgimin e kopjeve fizike

në prokurori, si procedura të nevojshme që lehtësojnë punën e përbashkët në raportet ndërmjet Prokurorisë dhe Policisë.

Gjithashtu, në përfundim të takimit, të dy bashkëbiseduesit, z.Veton Shabani dhe z. Basri Shabani, shprehën zotimin e tyre të përbashkët për forcimin dhe avancimin e bashkëpunimit të mëtejshëm në luftën kundër çfarëdolloj krimi që shfaqet.

Mbahet takimi i përbashkët i Komisionit për Administrimin e Prokurorive dhe Komisionit për Administrimin e Gjykatave

Prishtinë, 12 shtator 2023

Komisioni për Administrimin e Prokurorive i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Komisioni për Administrimin e Gjykatave i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të kryesuar nga z.Veton Shabani dhe z. Fahret Vellija, kanë mbajtur një takim të përbashkët, në të cilin morën pjesë anëtarë dhe udhëheqës të Projektit për Sistemin Informativ të Menaxhimit të Lëndëve (SMIL) dhe udhëheqës të njësisë organizative në kuadër të të dy këshillave.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i detajuar i sfidave që janë duke u shfaqur gjatë procesit të punës së prokurorëve dhe gjyqtarëve në SMIL dhe intensifikimi i angazhimit të përbashkët të këtyre dy komisioneve për lehtësimin e veprimtarisë së punës në këtë projekt madhor të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht, përfaqësuesit e këtyre komisioneve të KPK-së dhe KGJK-së janë pajtuar për nevojën e formimit të Grupit të përbashkët të punës së përdoruesve, i cili do të përbëhet nga prokurorë dhe gjyqtarë, si dhe nga stafi profesional, grup ky, i cili do të ketë për detyrë identifikimin dhe dhënien e propozimeve të komisionet për rregullimin dhe përmirësimin e procesit të punës gjatë vendosjes së të dhënave dhe procedimin e tyre për miratim në takimet e të dy këshillave përkatës.



Po ashtu, diskutimet e sotme janë përqendruar në mënyrat e thjeshtësimit të procedurave të futjes së të dhënave përmes SMIL-it dhe lehtësimin e ndjeshëm të shkëmbimit të tyre ndërmjet instancave prokuroriale dhe gjyqësore në përgjithësi dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Gjykatës Supreme në veçanti.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 20 shtator 2023

Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), i udhëhequr nga kryetari i këtij Komisioni, z. Armend Zenelaj, së bashku me anëtarët, z.Bahri Hyseni dhe z.Illir Morina, ka mbajtur takimin e radhës sipas agjendës së paraparë.



Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi për formimin e Grupit punues për hartimin e listës me afate të ruajtjes së dokumenteve arkivore, me ç'rast i njëjti është aprovuar nga anëtarët e këtij Komisioni.

Gjithashtu, gjatë takimit të Komisionit për Çështje Normative, u tha se ky grup përbën hapin e parë drejt hartimit të draftit të Udhëzimit Administrativ për Ruajtjen, Transferimin dhe Asgjësimin e Regjistrave dhe Lëndëve, si një akt mjaft i rëndësishëm gjatë procesit të punës në sistemin prokurorial.

Kryesuesi Maloku priti në takim përfaqësuesit e Këshillit të Lartë të Prokurorisë së Shqipërisë

Prishtinë, 21 shtator 2023

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z. Jetish Maloku, i shoqëruar nga Zëvendëskryesuesi dhe kryetarët e komisioneve të KPK-së ka pritur në takim Kryetarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë së Shqipërisë (KLPSH), Alfred Balla, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e KLPSH-së dhe prokurorë të tjerë.

Qëllimi i vizitës ishte diskutimi për së afërmi i përvojave dhe praktikave të mira dhe hulumtimi i formave të bashkëpunimit bilateral, në mënyrë që të avancohen proceset e punës në të dyja vendet.

Me këtë rast, Kryesuesi Maloku informoi Kryetarin Balla për proceset e funksionimit kushtetues e ligjor, duke theksuar përkushtimin e KPK-së dhe mekanizmave të saj për bashkëpunim të mëtijshëm.



Në kuadër të bashkëbisedimit të sotëm, përfaqësuesit e Këshillit të Lartë të Prokurorisë së Shqipërisë janë interesuar veçanërisht për metodologjinë e punës lidhur me procedurat dhe procesin e performancës, vlerësimit dhe disiplinimit të prokurorëve të shtetit në Republikën e Kosovës, me ç'rast Zëvendëskryesuesi i KPK-së, kryetari i Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve dhe ai i Komisionit për Akte Normative, i kanë njoftuar ata lidhur me aspektet e avancimit të bërë dhe mbështetjes së ofruar nga ana e partnerëve ndërkombëtarë.

Po ashtu është diskutuar edhe për sistemet e integruara të të dhënave që gjenerohen në mënyrë digjitale dhe është potencuar nevoja e intensifikimit të bashkëpunimit, qoftë edhe me anë të realizimit të takimeve të përbashkëta të këshillave përkatës, delegimit dhe caktimit të anëtarëve dhe përfaqësuesve nga këshillat e të dyja shteteve për të bashkëpunuar për çështjet me interes të veçantë.

Organizohet dita e dhurimit vullnetar të gjakut në sistemin prokurorial

Prishtinë, 25 shtator 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzion të Gjakut, organizuan ditën e dhurimit vullnetar të gjakut.

Dhurimi vullnetar i gjakut u krye nën kujdesin e ekipit të mjekësor të Qendrës Kombëtare të Kosovës për Transfuzion të Gjakut në ambientet e Prokurorit të Shtetit, me ç'rast kësaj iniciative iu përgjigjen një

numër i konsiderueshëm i punonjësve të sistemit prokurorial.

Sikurse, edhe herëve të tjera, edhe sot, përfaqësuesit e ekipit mjekësor të Qendrës Kombëtare të Kosovës për Transfuzion të Gjakut, shprehën mirënjohje për dhuruesit vullnetarë të gjakut të sistemit prokurorial.



Dhurim i gjakut nga punëtorët e sistemit prokurorial ka vazhduar vite me radhë, si një akt i domosdoshëm humanitar për shpëtimin e jetës së njerëzve në vendin tonë.

Kryesuesi i KPK-së priti në takim ambasadorin britanik

Prishtinë, 26 shtator 2023

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z.Jetish Maloku, priti në takim Ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, z. Nicholas Abbott.

Takimi i sotëm, Maloku-Abbott, është zhvilluar në frymën e bashkëpunimit të ndërsjellë, me ç'rast Kryesuesi Maloku falënderoi në mënyrë të veçantë Ambasadorin Abbott, duke shprehur vullnetin dhe përkushtimin e madh për të zhvilluar partneritetin e përbashkët në fushat përkatëse, në mënyrë që të ketë avancim dhe fuqizim të rendit dhe sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Nga ana tjetër, Ambasadori i e Mbretërisë së Bashkuar, z.Abbott, duke falënderuar Kryesuesin Maloku për pritjen, theksoi se misioni diplomatik i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë mirëpret dhe angazhohet vazhdimisht për fuqizimin e sektorit të drejtësisë, e në këtë kontekst edhe fuqizimin e institucioneve prokuroriale.

Bashkëbiseduesit u pajtuan gjatë takimit që iniciativat e përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit dypalësh për forcimin e rendit dhe zbatimin e ligjit të jetësohen duke u fokusuar pikërisht në proceset e reformave dhe rishikimit funksional të sistemit të drejtësisë,

proces ky, që vazhdon të ketë mbështetjen nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë.



Mbahet takimi i Komisionit për Administrim të Prokurorive

Prishtinë, 26 shtator 2023

Komisioni për Administrimin e Prokurorive i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga z.Veton Shabani, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët e këtij Komisioni dhe udhëheqësit e njëzive organizative të SKPK-së.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi lidhur me formimin e Grupit të punës së përdoruesve të SMIL-it, temë kjo, që doli nga takimi i përbashkët i Komisionit për Administrimin e Prokurorive dhe Komisionit për Administrimin e Gjykatave. Ky grup do të ketë për detyrë identifikimin dhe dhënien e propozimeve të komisioni për rregullimin dhe përmirësimin e procesit të punës gjatë vendosjes së të dhënave dhe procedimit të tyre për miratim në takimet e KPK-së.



Po ashtu, anëtarët e Komisionit janë njoftuar lidhur me progresin e arritur dhe aktivitetet që ka zhvilluar dhe që ka në plan për t'i zhvilluar Grupi punues për harmonizimin e legjislacionit në fuqi të formave shabllon, që përdoren nga prokuroritë pas ndryshimeve të fundit ligjore.

Në përfundim të takimit është diskutuar edhe për identifikimin e prokurorisë model lidhur me përdorimin e regjistrave fizikë.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel

Prishtinë, 26 shtator 2023

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), i udhëhequr nga prokurorja Ariana Shajkovci, mbajti takimin e radhës, në të cilin përveç anëtarëve, mori pjesë edhe U.D. Drejtoresha e Përgjithshme e Sekretariatit të KPK-së dhe udhëheqësit e njësive për buxhet dhe financa dhe burime njerëzore.



Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i Planit të ndryshuar dhe të plotësuar të personelit për vitin 2023 dhe harmonizimi i tij në përputhje me Rregulloren për Veprimtarinë, Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në Këshillin Prokurorial të Kosovës, me ç'rast i i njëjti

është aprovuar me plotësim dhe ndryshime dhe do të procedohet për miratim në njërin nga takimet e KPK-së.

Po ashtu, anëtarët e këtij Komisioni, pas shqyrtimit, kanë aprovuar edhe Raportin financiar për periudhën janar-qershor 2023 dhe shpenzimet deri më 31 gusht 2023.

Komunikatë nga takimi i jashtëzakonshëm i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 29 shtator 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Jetish Maloku, ka mbajtur një takim të jashtëzakonshëm për të diskutuar lidhur me hapat që do të ndërmerren pas miratimit të rekomandimit të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit të Kuvendit të Kosovës për shkarkimin e z.Agron Beka, që është zgjedhur nga radhët e fakulteteve juridike në cilësinë e anëtarit të KPK-së.



Me këtë rast, KPK-ja ka shprehur shqetësimin e vet të thellë me rastin e pranimit të informacionit gjatë ditës së djeshme për miratimin e rekomandimit të këtij komisioni.

KPK-ja, në takim e sotëm, diskutoi hollësisht aspektin procedural dhe ligjor lidhur me këtë iniciativë të Komisionit, që rezultoi se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit i Kuvendit të Kosovës, ka marrë veprime të ngutshme, pa shqyrtuar të gjitha provat, të cilat janë relevante për këtë iniciativë të tyre, prova këto, të cilat anëtarë i KPK-së, Agron Beka, i ofroi sot në takimin e jashtëzakonshëm (me vëllim voluminoz), të cilat demantojnë plotësisht të gjitha pretendimet e potencuara nga iniciatorët në Komisionin për

Legjislacion, për shkarkimin e anëtarit joprokuror të KPK-së.

Në mesin e shumë provave voluminoze që ofroi z.Beka ishin edhe disa dëshmi të komunikimit zyrtar me zyrtarët e lartë dhe kompetentë në institucione të rëndësishme shtetërore, të cilët, paraprakisht, ka më shumë se një vit që janë njoftuar mbi keqpërdorimet në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë, e të cilët deri sot e kësaj dite nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim ligjor për t'i parandaluar pasojat negative evidente, përkundrazi, mosveprimi i tyre ka shkaktuar krijimin e situatave për iniciimin e procedurave në organet e sistemit të drejtësisë.

Bazuar mbi këto që u cekën më lart, në takimin e jashtëzakonshëm të KPK-së, u tha se, të gjitha pretendimet e tjera të potencuara në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, demantohen nga provat që janë prezantuar para Këshillit Prokurorial nga anëtari joprokuror i KPK-së, në takimin e jashtëzakonshëm të mbajtur, sot, më 29 shtator 2023.

Lidhur me shkeljet e pretenduara nga Komisioni, KPK-ja, njofton opinionin e gjerë publik se, në rastin konkret nuk ka asnjë shkelje të dispozitave të Kushtetutës, Ligjit të KPK-së dhe të akteve tjera nënligjore, por hipotetikisht, edhe po që se do të kishte shkelje, qoftë edhe në të ardhmen nga ndonjë anëtar i KPK-së, organi apo institucioni i vetëm kompetent (në bazë të legjislacionit në fuqi) për t'i shqyrtuar shkeljet eventuale është Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe mekanizmat e tij, si institucion kushtetues dhe i pavarur.

Andaj, në përfundim të takimit të sotëm të jashtëzakonshëm, u theksua se veprimet e tilla të Komisionit për Legjislacion paraqesin tendencë të hapur politike për të ndërhyrë në funksionimin e rregullt dhe cenimin e mandatit kushtetues dhe ligjor të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.

Zëvendëskryesuesi i KPK-së dhe Kryetari i Komisionit për Vlerësimin e Përformancës së Prokurorëve pritën në takim një delegacion të sistemit prokurorial të autoriteteve palestineze

Prishtinë, 29 shtator 2023

Zëvendëskryesuesi i KPK-së, z.Veton Shabani, i shoqëruar nga Kryetari i Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, z. Ardian Hajrdaraj, priti në takim një delegacion të përfaqësuesve të

sistemit prokurorial të autoriteteve palestineze, të udhëhequr nga Zëvendëskryesuesi i Përgjithshëm, z.Khaled Jamal Mohamad Awad, të cilët janë duke qëndruar për një vizitë studimore në vendin tonë.

Fillimisht, Zëvendëskryesuesi Shabani, falënderoi delegacionin palestinez për vizitën e tyre, duke shprehur përkushtimin e bashkëpunimit të mëtejshëm lidhur me shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës me atë të sistemit prokurorial të autoriteteve palestineze.

Para mysafirëve palestinezë, z.Shabani ka prezantuar aktivitetet dhe veprimtarinë e gjithëmbarshme që zhvillohet nga Këshilli Prokurorial dhe trupat e tij, si dhe ndërveprimin me institucionin e Prokurorit të Shtetit, kurse kryetari i Komisionit për Vlerësimin e Përformancës së Prokurorëve, z.Hajdaraj, prezantoi aktivitetet dhe funksionimin praktik e teorik të mekanizmave disiplinorë për vlerësimin, disiplinimin dhe performancën e prokurorëve të shteti, duke vënë në pah rolin dhe funksionimin e tyre, procedurat e inicimit të rasteve ndaj prokurorëve, si dhe Kodin e Etikës dhe Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve.



Me këtë rast, delegacioni i sistemit prokurorial të autoriteteve palestineze, vlerësoi lart mikpritjen dhe bashkëpunimin e ofruar nga përfaqësuesit kosovarë të institucioneve prokuroriale, duke vënë theksin tek informacionet e çmuara që morën nga përfaqësuesit e sistemit prokurorial.

Gjithashtu, paraprakisht, me përfaqësuesit e autoriteteve palestineze ka zhvilluar një takim edhe Ushtruesja e Detyrës së Drejtoreshës të Sekretariatit të KPK-së, znj.Shqipe Hykolli, së bashku me Koordinatorin e Komisioneve të KPK-së, z.Besim Kusari, si dhe përfaqësuesit që mbështetësin panelet disiplinore, me ç'rast kanë bashkëbiseduar lidhur me ofrimin e shërbimeve profesionale të Sekretariatit të KPK-së, si organi qendror administrativ në sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës dhe mbështetjen e që merr KPK-ja për mekanizmat disiplinorë dhe të

vlerësimin të performancës së prokurorëve dhe kryeprokurorëve, si dhe mbështetjen e paneleve disiplinore të KPK-së.

Kjo vizitë është mundësuar nga Zyra e UNDP-së dhe realizohet në kuadër të Programit për Qasje në Drejtësi, program ky, i përbashkët i tri agjencive të Kombeve të Bashkuara (UNDP, UN Women dhe UNICEF).

Në përfundim të takimit janë shqyrtuar edhe kërkesa për plotësimin dhe ndryshimin e Planit të Personelit Administrativ për vitin 2023 dhe kërkesa për ricaktimin e dy prokurorëve të Shtetit në prokuroritë e vendit.

Mbahet Takimi i 234-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 29 shtator 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Jetish Maloku, ka mbajtur Takimin e 234-të me radhë, sipas agjendës së paraparë.

Fillimisht është themeluar Paneli hetimor për rastin e një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe janë miratuar Raporti analitik i Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për veprat penale karakteristike për periudhën kohore 2013- 2022, me disa rekomandime të anëtarëve të KPK-së dhe Raporti vjetor për vitin 2022 për zbatimin e Planit të Veprimit të Planit Strategjik të Sistemit Prokurorial (2022-2024).



Po gjatë këtij takimi, Këshilli Prokurorial themeloi Komisionin për Kushte të Tregut të Punës, në përputhje me Rregulloren për Shtesat dhe Kompensimet e të Punësuarve në Sistemin Prokurorial, në përbërje të të cilit do të jenë – një anëtar i Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel, një anëtar i Komisionit për Çështje Normative dhe një anëtar nga radhët e administratës së sistemit prokurorial.

Gjithashtu, KPK-ja caktoi znj. Shqipe Hykolli në detyrën e Ushtrueses së Detyrës të Drejtoreshës së Përgjithshme të Sekretariatit të KPK-së deri në zgjidhjen e drejtorit të ri dhe trajtoi Raportin e Panelit Hetimor ndaj një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.